

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6831
E mërkurë, 22 shkurt 2023
çmimi 0.40 €

PDK-ja e dërgon në Kushtetuese Ligjin për Byronë

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

BE-ja KUNDËR LIGJIT PËR PAGA DHE PËR ZYRTARËT PUBLIKË

FAQE 4-5



Annual Conference

PAR PROGRESS KOSOVO

Challenges, progress and path forward

Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, e ka kritikuar Qeverinë e Kosovës se nuk ka marrë parasysh komentet e BE-së në lidhje me Ligjin për Paga dhe Ligjin për

Zyrtarët Publikë. Ai ka thënë se BE-ja nuk pajtohet që këto ligje janë bërë në procedurë të shpejtë dhe nuk janë konsultuar me palët e interesit. Ndërkaq kryeministri Albin Kurti ka

thënë se zbatimi i këtyre dy ligjeve do të rezultojë me rritjen e performancës në administratën publike, rritjen e efikasitetit dhe të cilësisë së shërbimeve

KURTI: DUHET T'I PËRMBAHEMI PROPOZIMIT EVROPIAN E JO INTERESIT TË NJËRËS PALË

FAQE 3



DEKOROHEN USHTARËT E FSK-së QË ISHIN PJESË E OPERACIONIT TË KËRKIM-SHPËTIMIT NË TURQI

AKTUALE



PAVARËSISHT PREJ PROTESTAVE MASIVE, MACRONI QËNDRON PRAPA REFORMAVE NË PENSIONE

F. 2

PACOLLI: GJENDJA FINANCIARE E KOMPANIVE PUBLIKE ËSHTË KATASTROFIKE

F. 5

RASTI I ASTRIT DEHARIT, INTERVISTOHET HAKI ABAZI

F. 6

DEPUTETI REÇICA VAZHDON TAKIMET NË DIASPORË, MERR PËRKRAHJE PËR FUQIZIMIN E PDK-së

F. 6

EKONOMI



HOTI: MJERË PËR ATË EKONOMI KU RRITEN SUBVENCIONET E ZVOGËLOHEN INVESTIMET!

F. 8

DYFISHOHET PAGESA E TATIMEVE NGA ESTRADA PËR VITIN 2022

F. 8

SPORT



PRISHTINA KËRKON KËNDELLJEN NDAJ DRITËS

F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shefi i NATO-s i kërkon Putinin ta rishqyrtojë pezullimin e traktatit të armëve

BRUKSEL, 21 SHKURT - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, i ka kërkuar Rusisë ta rishqyrtojë vendimin e saj për pezullimin e pjesëmarrjes në traktatin me Shtetet e Bashkuara që kufizon arsenalin strategjik bërthamor të të dyja palëve. Në fjalimin e 21 shkurtit drejtuar kombit, presidenti rus Vladimir Putin tha se është "i detyruar të njoftojë se Rusia është duke e pezulluar pjesëmarrjen në traktatin për armët strategjike".

Ai ka thënë se Rusia nuk po tërhiqet nga marrëveshja, mirëpo vetëm po e pezullon pjesëmarrjen.

I ashtuquajtur START-i i Ri është traktati i vetëm për armët bërthamore në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë i cili është

zgjatur për pesë vjet më 2021.

I nënshkruar fillimisht më 2010, ky traktat ua kufizon palëve posedimin e kokave bërthamore me reze të gjatë në 1.550, shifër më e vogël sesa ajo që ka qenë në marrëveshjen fillestare.

Stoltenbergu tha se Rusia po përgatitet për eskalim të luftës e jo për paqe.

Ai tha se NATO po planifikon të mbajë një takim me ekspertë të prokurimit të armëve për t'u siguruar që Ukraina do t'i ketë armët që i nevojiten.

Diplomatët e lartë të Bashkimit Evropian paralajmëruan të hënën se duhet të gjenden mënyra për të ofruar shpejt mijëra predha artilerie për Ukrainën ose BE-ja do të duhet të përballet me mundësinë e

humbjes së luftës kundër Rusisë.

Javën e kaluar Stoltenbergu tha se koha e pritjes për furnizimin e "municioneve të kalibrit të madh është rritur nga 12 në 28 muaj".

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky u ka bërë thirrje aleatëve të tij perëndimorë ta shpejtojnë mbështetjen e tyre ushtarake, duke paralajmëruar se vonesat do të jenë në dobi të Rusisë tani që po afrohet përvjetori i parë i nisjes së luftës në Ukrainë më 24 shkurt.

NATO beson se Rusia ka nisur një ofensivë të re në javët e fundit, duke rritur intensitetin e sulmeve në Ukrainën lindore, ndërkohë që edhe po shton forcat në pjesën jugore. Zyrtarët kanë thënë se Ukraina ka të ngjarë ta nisë kundërofensivën e saj në pranverë.



Pavarësisht prej protestave masive, Macroni qëndron prapa reformave në pensione

PARIS, 21 SHKURT - Presidenti francez Emmanuel Macron do t'i vazhdojë planet e tij për reformën në pensione pavarësisht prej protestave masive që kanë zgjatur me javë të tëra në Francë. "Njerëzit thellë-thellë e dinë se duhet të punojmë pak më gjatë, përndryshe nuk do të jemi në gjendje t'i financojmë pensionet tona siç duhet", tha ai të martën në Paris.

Plani i Macronit për ta rritur moshën e pensionimit nga 62 në 64 vjeç është reforma e tij më e madhe gjatë mandatit të dytë presidencial.

Për javë të tëra, Macroni nuk ishte



deklaruar publikisht për këtë çështje, e cila nxiti protesta masive në Francë. Sondazhet e opinionit

tregojnë se shumica e francezëve janë kundër planit. "Reformat nuk kanë alternativë", shtoi ai, sepse

"publiku as nuk dëshiron të paguajë kontribute më të larta dhe as të pranojë ulje të pensioneve".

Franca ka moshën më të ulët të kualifikimit për pension shtetëror në mesin e ekonomive më të mëdha evropiane.

Pensioni mesatar është 1 400 euro në muaj pasi të zbriten taksat.

Qeveria ka thënë se ndryshimet janë të nevojshme për ta garantuar të ardhmen e financimit të sistemit pensional, që pritet të kalojë në deficit në vitet e ardhshme - për shkak të plakjes së popullsisë.

Tetë sindikatat kryesore të punëtorëve të Francës janë duke i

bërë thirrje qeverisë që të heqë dorë nga masa e moshës.

Është hera e parë që nga viti 2010 që të gjitha sindikatat i bashkojnë forcat kundër një reforme të planifikuar.

Kundërshtarët thonë se ka mënyra të tjera për ta siguruar financimin e pensioneve - për shembull nëpërmjet një takse për të pasurit ose rritjes së kontributeve në listën e pagave, që paguhen nga punëdhënësit.

Qeveria synon ta miratojë legjislacionin e ri deri në verë në mënyrë që ndryshimet të hyjnë në fuqi në shtator.

Tetë të vdekur dhe qindra të plagosur si pasojë e tërmetit të ri në Turqi

ANKARA, 21 SHKURT - Tetë njerëz kanë vdekur në Siri dhe Turqi pas tërmetit 6.4 shkallë të Rihterit që ka goditur të hënën jugun e Turqisë, dy javë pas tërmetit shkatërrues që vrau mbi 45 000 njerëz.

Autoriteti turk i menaxhimit të fatkeqësive tha se gjashtë persona u vranë dhe 294 të tjerë u plagosën në Turqi.

Ndërsa në Siri, një grua dhe një vajzë vdiqën si pasojë e panikut gjatë tërmetit në provincat Hama dhe Tartus, thanë mediet pro-qeveritare.

Epiqendra e tërmetit ishte në qytetin Defne, në provincën Hataj të Turqisë, e cila kufizohet me Sirinë.

Tërmeti është ndier gjithashtu në Jordani, Qipro, Izrael, Liban dhe Egjipt dhe u pasua nga një tërmet i dytë me magnitudë 5.8 shkallë të Rihterit.

Hataj ishte një nga provincat më të goditura në Turqi në tërmetin e 6 shkurtit. Mijëra ndërtesa u shkatërruan para dy javësh dhe

tërmeti i së hënës i dëmtoi edhe më tej ato.

Sipas autoriteteve turke, vetëm në Turqi kanë vdekur mbi 41 mijë persona nga tërmeti i 6 shkurtit, derisa besohet se mbi 385 000 banesa janë shkatërruar apo janë dëmtuar rëndë. Ndërsa në Siri kanë vdekur rreth 5 mijë persona.

Komisioni Evropian, së bashku me Presidencën Suedeze të Këshillit, do të organizojnë më 16 mars një konferencë të madhe donatorësh në Bruksel, për të mbledhur kontribute për ndihmë për Turqinë dhe Sirinë, në përballje me pasojat e tmerrshme të tërmetit që ka goditur pjesë të këtyre dy vendeve. BE-ja edhe deri tash i ka ndihmuar Turqinë dhe Sirinë përmes dërgimit të ekipeve për intervenim të shpejtë, por edhe përmes ndihmës materiale.

Ndërsa Departamenti amerikan i Shtetit ka thënë se ndihma totale amerikane për të prekurit nga tërmeti në Siri dhe Turqi ka arritur në 185 milionë dollarë.



Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kurti: Duhet t'i përmbahemi propozimit evropian e jo interesit të njërës palë

PRISHTINË, 21 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se nga takimi i 27 shkurtit me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, pret të ketë diskutime mbi bazën e propozimit evropian, por tha se për gjërat e tjera nuk mund të flasë tani "edhe për shkak se jo pak varet nga ndërmjetësuesit e dialogut". "Pas ditës së hënë do të dimë më shumë se çka e ku", tha ai pas një ngjarjeje të zhvilluar në Prishtinë.

I pyetur nëse në takimin e së hënës do të ketë diskutime për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, Kurti tha se

beson se duhet "t'i përmbahemi propozimit që kemi marrë e jo interesit të njërës palë".

Bashkimi Evropian ka thënë se temë e diskutimit në takimin e nivelit të lartë Kurti - Vuçiq do të jetë propozimi evropian për normalizimin e plotë të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në pikën 10 të karakteristikave të propozimit evropian, të cilat Kurti i lexoi në Kuvendin e Kosovës më 13 shkurt, thuhet se "të gjitha marrëveshjet e Brukselit do të duhej të zbatoheshin nga palët".

Kosova dhe Serbia më 2013 dhe

2015 kanë arritur marrëveshje për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Por, Gjykata Kushtetuese e Kosovës tha se marrëveshja e vitit 2015 nuk është plotësisht në harmoni me Kushtetutën, duke shtuar se të 23 pikat që janë në kundërshtim me frymën e Kushtetutës, mund të harmonizohen.

BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara kërkojnë nga Kosova t'i zbatojë marrëveshjet për Asociacionin. Kurti kundërshton themelimin e asociacionit njëetnik me kompetenca ekzekutive, ndërsa Serbia kërkon që

Asociacioni të ketë kompetenca ekzekutive. Por, ShBA-ja ka thënë se e kundërshton "krijimin e një entiteti që i ngjan Republikës Sërpska në Bosnjë-Hercegovinë".

Propozimi evropian u është dorëzuar Kosovës dhe Serbisë në shtator të vitit të kaluar. Palët kanë konfirmuar se e pranojnë këtë dokument, por ai nuk është bërë publik. Megjithatë, aty nuk përmendet në mënyrë specifike njohja, por parashihen të drejta të barabarta për Kosovën dhe Serbinë, respektim i integritetit territorial, paprekshmëri e

kufijve, njohje e simboleve shtetërore dhe aranzhim i veçantë për komunitetin serb në Kosovë.

Kurti dhe Vuçiqi nuk kanë zhvilluar takim në kuadër të dialogut të Brukselit që nga nëntori i vitit 2022. Kosova dhe Serbia i kanë nisur negociatat e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian më 2011. Palët kanë synime të ndryshme sa i përket marrëveshjes finale, që synohet të arrihet në këtë proces. Kosova insiston në njohje reciproke, Serbia kërkon një zgjidhje kompromisi, pa specifikuar se për çfarë kompromisi bëhet fjalë.



Karakteristikat e propozimit evropian

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, më 13 shkurt në Kuvend lexoi "disa karakteristika" të versionit të parë të propozimit evropian për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Këto karakteristika, sipas Kurtit, janë: 1. Propozimi bazohet në modelin e marrëveshjes gjermano-gjermane të vitit 1972 dhe të shumë modeleve të tjera të njohjeve de-facto të shtetësisë në historinë e marrëdhënieve ndërshtetërore p.sh. marrëveshja Japoni-Kore Jugore. Vetë Gjykata Kushtetuese e Republikës Federative të

Gjermanisë kishte konstatuar në vitin 1973 që marrëveshja gjermano-gjermane ngërthente në vete njohjen de-facto të shtetësisë së njëra-tjetres dhe njohjen e integritetit territorial nga prizmi i së drejtës ndërkombëtare.

2. Propozimi ngërthente në vete pranimin nga palët të parimit të barazisë në sistemin ndërkombëtar, i cili është parimi kyç i Kartës së Kombeve të Bashkuara sa iu përket marrëdhënieve ndërmjet shteteve të pavarura.

3. Propozimi, gjithashtu, përcaktonte njohjen nga palët, të

parimeve të barazisë së sovranëve, integritetit territorial, zgjidhjen paqësore të konflikteve në marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

4. Propozimi përfshinte heqjen dorë të Serbisë nga pengimi i anëtarësimit të Kosovës në çdo organizatë ndërkombëtare që përfshin jo vetëm organizatat në kontinentin evropian, por edhe ato me shtrirje universale si OKB, UNESCO apo NATO.

5. Propozimi përfshinte njohjen e palëve ndaj njëra-tjetres të së drejtës së përfaqësimit shtetëror në terrenin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

6. Propozimi përfshinte shkëmbimin e zyrave të përhershme diplomatike në formën e legatëve që janë ambasada faktike e që përbënin formën normale të marrëdhënieve ndërshtetërore para Luftës së Dytë Botërore.

7. Propozimi përmbante njohjen e dokumenteve shtetërore që kanë efekt ndërkombëtar të shtetësisë për shtetasit, përfshirë të pasaportave të njëra-tjetres nga njëra-tjetra.

8. Propozimi, megjithatë, përmbante edhe dy norma që lidheshin me të drejtat e komunitetit serb në Kosovë: E

para, normën që e përcaktonte komuniteti serb, do të ketë një të drejtë të vetëmenaxhimit në përputhje me instrumentet, konventat e Këshillit të Evropës, ashtu siç ka çdo komunitet minoritar në shtetet anëtare në Këshillin Evropës.

Dhe, e dyta, formalizimin e statusit të Kishës Ortodokse Serbe, gjë që ne veçse e kemi bërë përmes njohjes së ekzistencës së kishës në Ligjin tonë për Komunitetet Fetare në Kosovë. 9. Pika 10, e fundit, parashihet rregullën që të gjitha marrëveshjet e Brukselit do të duhej të zbatoheshin nga palët.



BE-ja kundër Ligjit për Paga dhe për Zyrтарët Publikë

Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, e ka kritikuar Qeverinë e Kosovës se nuk ka marrë parasysh komentet e BE-së në lidhje me Ligjin për Paga dhe Ligjin për Zyrтарët Publikë. Ai ka thënë se BE-ja nuk pajtohet që këto ligje janë bërë në procedurë të shpejtë dhe nuk janë konsultuar me palët e interesit. Ndërkaq kryeministri Albin Kurti ka thënë se zbatimi i këtyre dy ligjeve do të rezultojë me rritjen e performancës në administratën publike, rritjen e efikasitetit dhe të cilësisë së shërbimeve

EPOKA ERE**Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 21 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, së bashku me shefin e BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, kanë marrë pjesë në konferencën vjetore "PAR-Progresi në Kosovë 2023" të organizuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS).

Në fjalën e tij para të pranishmëve, kryeministri Kurti përmendi rëndësinë e reformës në administratën publike, për të cilën vlerësoi se është parakusht për zhvillim edhe të sektorëve të tjerë dhe

shtoi se Republika e Kosovës e ka përcaktuar orientimin dhe politikat e saj shtetërore drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. "Në kontekstin e modelit që adreson këto kërkesa për reformim, për qeverinë ka qenë jetik fokusi që procesi në tërësi të jetë i bazuar në parime dhe vlera të cilat ne i ndajmë me shtetet demokratike, pra meritokraci, transparencë, llogaridhënie, efikasitet dhe mosdiskriminim", ka thënë Kurti.

Më tej, ai ka thënë se qeveria ka ndërmarrë hapa konkretë që ndërlidhen me reformën në administratën publike, i cili

është fokusuar në planifikimin strategjik e i cili ngërthen Planin Kombëtar për Zhvillim; aprovimin e Strategjisë për Reformë në Administratë Publike për periudhën 2022-2027; Strategjinë për e-qeverisje dhe atë për siguri kibernetike, që përbëjnë njashtu boshtin e një planifikimi të mirëfillt të reformave si dhe hyrjen në fuqi të Ligjit për Paga në Sektorin Publik. Për këtë të fundit, kryeministri tha se për herë të parë kanë një sistem të unifikuar të pagës në sektorin publik dhe po mënjanohet pabarazia drastike në pagë çfarë ishte në të kaluarën. "Besoj se është e evidente se Republika e Kosovës ka bërë progres në fushën e digitalizimit në administratën publike. Një numër i madh i shërbimeve publike është digitalizuar dhe platforma shtetërore e-Kosova ka aktualisht mbi 761 mijë përdorues të regjistruar. Pra, përafërsisht sa dy anëtarë në familje apo dyfishi i familjeve që kemi në Kosovë", ka

deklaruar Kurti.

Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, e ka kritikuar Qeverinë e Kosovës se nuk ka marrë parasysh komentet e BE-së në lidhje me Ligjin për Paga dhe Ligjin për Zyrтарët Publikë.

Ai ka thënë se BE-ja nuk pajtohet me procedurën e shpejtë që janë bërë këto ligje dhe se nuk janë konsultuar me palët e interesit. "Reforma në administratën publike është një qelës kyç për t'u bashkuar në BE ku ofrohen shërbime cilësore për qytetarët dhe bizneset. Dy miratimet e ligjeve që janë bërë vitin e kaluar; Ligji për Paga dhe ai për Zyrтарët Publikë, dua të shpreh qëndrim kundër. Ne nuk pajtohemi sepse këto ligje janë bërë në procedurë të shpejtë. Ato duhet të konsultohen me palët e interesit dhe kjo nuk është bërë. Këto konsultime është dashur të bëhen me shoqërinë civile. Ligji i ri për Zyrтарët Publikë lidhet me parimet e administratës publike. Ne pranojmë që ka një boshllëk në këtë dhe BE

nuk pajtohet me mënyrën se si qeveria ka zgjedhur t'i shqyrtojë këto ligje dhe komentet që ka bërë BE-ja dhe SIGMA nuk janë marrë parasysh nga qeveria", ka thënë Szunyog, duke shtuar se zyrтарët publikë i vendos në një rrezik të korrupsionit dhe ndikimit politik. "Ligji i ri nuk do të krijojë kushte për të rekrutuar njerëz në këto pozita të lira. Sa i përket Ligjit të Pagave, është mirë që ekziston, megjithatë është dashur të vendoset pas organizimit të administratës publike. Kjo reformë është për një kohë të gjatë. Si BE do të vazhdojmë ta mbikëqyrim reformën në administratën publike", ka theksuar Szunyog. Ndërkaq kryeministri Kurti ka thënë se këto dy ligje synojnë profesionalizimin e administratës publike përmes promovimit të meritokracisë, krijimin e mundësive për tërheqjen dhe mbajtjen e kapaciteteve profesionale në sistemin tonë institucional, shpërbllimin e drejtë të kontributit ndaj shtetit,

Bislimi pret përfaqësuesit e OEMVP-së, bisedojnë për mundësinë e bashkëpunimit

PRISHTINË, 21 SHKURT - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi, u takua me përfaqësues të Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore (OEMVP). Në takim u bisedua mbi mundësitë e koordinimit dhe shtyrjes përpara të projekteve me benefite të përbashkëta, që ndërtojnë ura të bashkëpunimit. Përfaqësuesit e OEMVP theksuan mbështetjen e tyre ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ata shtuan se e shohin Procesin e Berlinit si mekanizëm të duhur të mbrojtjes dhe të produkteve të

tyre. Zëvendëskryeministri Bislimi tha se qeveria e ka bërë të qartë përmes vendimeve të saj se cili është pozicionimi i Kosovës në rajon dhe se si e shohim rolin tonë. Ai përmendi vendimin gjatë qeverisë Kurti I të ndarjes së 10 mijë eurove për rindërtimin e shkollës së djegur në Dacaj - Rozhajë, ndarjen e 500 mijë eurove për Luginën e Preshevës si mbështetje financiare për përballimin e gjendjes së krijuar nga pandemia, deri te dy milionë eurot e ndara nga buxheti si mbështetje për Luginën gjatë vitit 2022. Në takim u shprehën aspekte në të cilat mund të punohet

bashkërisht edhe për t'i lehtësuar problematikat me të cilat po përballen bizneset shqiptare atje si resurset njerëzore, kuadrat e reja, fuqia punëtore dhe tregu i punës. "Prandaj është e rëndësishme ruajtja e tregut, eliminimi i barrierave burokratike dhe forcimi i lidhjes ekonomike. Puna do të vijojë në shtimin e bashkëpunimit, ku ka sinjale pozitive marrë parasysh edhe rritjen e eksportit dhe importit gjatë vitit të kaluar mes dy vendeve. Ndërtimi i rrugëve dhe zonave të përbashkëta industriale e ekonomike, mbeten prioritare me qëllim thellimin e bashkëpunimit dhe përafrimit mes nesh", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.



kthimin e trurit nga diaspora, krijimin e mundësive për avancim për zyrtarët brenda administratës dhe ndërveprim me sektorin privat. "Zbatimi i tyre do të rezultojë me rritjen e performancës së administratës publike, rritjen e efikasitetit dhe të cilësisë së shërbimeve që sikur qytetarët ashtu edhe bizneset presin me të drejtë t'i marrin", ka deklaruar Kurti. Arbëresha Loxha Stublla, drejtoreshë ekzekutive e GLPS-së, ka thënë se reforma në administratën publike është proces fundamental për shtetet që kanë synim anëtarësimin në Bashkimin Evropian. "Është viti i dytë që

GPLS-ja është duke organizuar këtë konferencë, e cila është për reformat e administratës publike. Këtë vit jemi munduar t'i trajtojmë temat që janë sfiduese. Reforma e administratës është një ndër proceset fundamentale të shteteve që kanë për qëllim integrimin në BE. Këto proces e definojnë atë që e bëjnë administratën që të jetë efikase për qytetarët dhe për buxhetin e shtetit", ka thënë Stublla. Kurse Peter Vagi, këshilltar i lartë i politikave dhe Menaxher për Kosovën Sigma/OECD, përgëzoi qasjen dhe miratimin e kornizës strategjike për reforma në

administratë publike. "Duhet ta përgëzojmë qasjen dhe miratimin e kornizës strategjike për reformën në administratën publike. Është hap i madh përpara se prej vonesës prej dy vjetësh më në fund e kemi një kornizë të plotë. Në reformën në administratën publike është e rëndësishme të përfshihen të gjitha elementet e saj. Në vend se të shikojmë sa larg ka ecur Kosova, rezultatet e programit të reformës ose zbatimit të strategjive tregojnë që rreth 45 për qind e reformave janë zbatuar. Përparim është bërë, por nuk mjafton", ka thënë Vagi.

Pacolli: Gjendja financiare e kompanive publike është katastrofike

PRISHTINË, 21 SHKURT - Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Behgjet Pacolli, ka reaguar ndaj qeverisë Kurti në raport me kompanitë publike dhe mosreagimin e saj për të investuar në to. Sipas Pacollit, kryetari i Vetëvendosjes dhe kryeministri i tanishëm



Albin Kurti thoshte gjithmonë se nëse ai do të qeverisë, do të ndodhin investime më të mëdha në kompanitë publike, si Trepça, KEDS-i, Infrakosi etj. "Fatkeqësisht, nuk po del ashtu. Jo vetëm që kompanitë në fjalë nuk gjenerojnë të hyra, por edhe gjendja e tyre financiare është katastrofike. Siç shihet, ideologjia kiensiane, në një shoqëri demokratike me treg liberal, nuk funksionon. T'ua lëmë ekonominë e Kosovës profesionistëve dhe jo ideologëve", ka shkruar Pacolli në "Facebook".



Lladrovci me bashkëpunëtorë bënë homazhe te varri i Shaban Polluzhës

DRENAS, 21 SHKURT - Me rastin e shënimit të 78-vjetorit të rënies së heroit të kombit Shaban Polluzha, kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, me bashkëpunëtorë, kanë bërë homazhe pranë varrit të tij në fshatin Polluzhë të Drenasit si dhe kanë vendosur buqeta me lule të freskëta. Shaban Polluzha lindi në Polluzhë të Drenasit më 1871. Mbiemrin e mori sipas fshatit të lindjes, ndërsa i përket fisit Kastrati. U rrit dhe u edukua në një familje me traditë kombëtare, e njohur edhe për zgjidhjen e konflikteve ndërfamiljare e ndërnerëzore. Ishte edhe kryetar i Këshillit Pajtues në Drenicë. Shaban Polluzha ra heroikisht më 21 shkurt të vitit 1945, pas një lufte të ashpër në kullat e Hasan Sylës në Tërstenik, kundër divizioneve të shumta ushtarake jugosllave të cilat vrisnin dhe plaçkitnin popullsinë civile.



Përmbytjet në Skenderaj, FINCA ndihmon me 6 000 euro

SKENDERAJ, 21 SHKURT - Institucioni mikrofinanciar FINCA e ka ndihmuar komunën e Skenderajt me 6 000 euro nëpërmjet Fondit Emergjent të Vërshimeve për familjet e prekura nga përmbytjet e 19 janarit. Kryetari i komunës, Fadil Nura, është shprehur falënderues ndaj institucionit në fjalë, për solidarizimin me familjet e goditura nga fatkeqësia e vërshimeve.

Rasti i Astrit Deharit, intervistohet Haki Abazi

Prishtinë, 21 shkurt - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Haki Abazi, është intervistuar të martën nga Prokuroria Speciale lidhur me çështjen e provave në rastin e Astrit Deharit.

Pas intervistimit, deputeti Abazi ka thënë para gazetarëve se çështja e provave të Astrit Deharit i takon Prokurorisë dhe hetuesisë dhe ai nuk mund të flasë asgjë tjetër. "Ashtu siç e kam dhënë deklaratën në hollin e Kuvendit, është çështje e Prokurorisë që të merret me këtë dhe ta realizojë drejtësinë. Nuk mund të jap asnjë informacion mbi këtë çështje, meqë janë çështje të hetuesisë dhe të prokurorisë. Ajo çfarë them unë si deputet dhe si qytetar i lirë i Republikës së Kosovës, të cilit i garantohet e drejta e fjalës, nuk do të ndalem pavarësisht prej limitimeve që mund të ekzistojnë nga presioni deri në realizimin e të drejtave të mia si deputet dhe si qytetar në një shoqëri normale", ka thënë

Abazi.

Ai në javën që lamë pas ka deklaruar se ekzistojnë video-incizimet ku shihet se kush i ka zhdukur mostrat e aktivistit Astrit Dehari. Abazi ka kërkuar nga Prokuroria t'i intervistojë kryeministrin Albin Kurti dhe ministren e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, lidhur me rastin.

Ndërkaq kryeministri Albin Kurti ka thënë të martën se akuzat e Abazit janë të pavërteta dhe të pasakta. "Ato nuk janë të vërteta dhe nuk janë të sakta, është përgjigjur për këtë ministria e Drejtësisë. Lëvizja Vetëvendosje është subjekti jo vetëm më i madh, por edhe më demokratik në Republikën e Kosovës dhe të gjitha çështjet ne edhe i diskutojmë hapur në forumet tona, por në të njëjtën kohë secili deputet shpreh qëndrimet e veta", ka thënë Kurti.

Kurti ka pohuar se nuk mban përgjegjësi për fjalën publike të dikujt tjetër.

Më 8 dhjetor të vitit të kaluar 12



mostra të Astrit Deharit janë zhdukur nga Laboratori i Toksikologjisë në Institutin e Mjekësisë Ligjore.

Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, pati thënë se ky akt i rëndë është vërejtur gjatë bartjes

së mostrave nga frigoriferët e vjetër në ata të rinj. Sipas saj, ky veprim ka për qëllim ta dështojë përfundimisht procesin hetimor për vdekjen e Deharit.

Lidhur me rastin janë pezulluar nga puna katër zyrtarë të Institutit

të Mjekësisë Ligjore (IML) dhe më pas janë kthyer sërish në punë. Por, Abazi pretendon se IML-ja është nën vëzhgim të kamerave 24 orë dhe, sipas tij, dihet qartë se kush ka hyrë brenda frigoriferit për t'i nxjerrë mostrat.

Deputeti Reçica vazhdon takimet në diasporë, merr përkrahje për fuqizimin e PDK-së

PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Deputeti Elmi Reçica, njëherësh udhëheqës i Departamentit të Diasporës në Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), ka mbajtur një takim me bashkatdhetarë, veprimtarë të shquar dhe biznesmenë që

jetojnë dhe punojnë në Zvicër, struktura të Degës së PDK-së, si dhe bashkatdhetarë nga Dusseldorf, Hamburgu dhe Munihu. "Mërgata jonë po e fuqizon gjithnjë e më shumë angazhimin për Kosovën dhe mbështetjen për Partinë

Demokratike të Kosovës, duke u bashkuar kështu rreth vizionit për një të ardhme të ndritur dhe për t'ia kthyer dinjitetin dhe qeverisjen e mirë Kosovës", ka thënë Reçica.

Reçica gjatë qëndrimit në Zvicër, në kuadër në festimit të



15-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, ka takuar shumë mërgimtarë të suksesshëm, të cilët kanë shprehur interesim për të bashkëpunuar në interes të vendit. "Hektor Beqiri dhe Isa Gashi janë veprimtarë dhe

atdhetarë të shquar, njëherësh biznesmenë shumë të suksesshëm, të cilët gëzojnë autoritet dhe besueshmëri si të bashkatdhetarët, po ashtu të shteti mirëprirës, Gjermania ku ata jetojnë dhe punojnë", ka shkruar Reçica në "Facebook".

PDK-ja e dërgon në Kushtetuese Ligjin për Byronë

PRISHTINË, 21 SHKURT - Ligji për Byronë shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme është kontestuar në Gjykatën Kushtetuese nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Lajmin e ka konfirmuar për "Ekonomia Online", koordinatori i Departamentit për Drejtësi në kuadër të Kabinetit të Qeverisjes së Mirë në PDK, Përparim Gruda.

Më 9 shkurt 2023 Kuvendi i Kosovës e ka miratuar në lexim të dytë Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Afati për dorëzimin e kërkesës në Kushtetuese, sipas Nenit 113.5 të Kushtetutës së Kosovës, parashtrohet brenda një afati prej tetë ditësh nga dita e miratimit të ligjit ose vendimit të caktuar.

Të hënën ka qenë dita e

fundit, kur pala e autorizuar, në këtë rast dhjetë deputetë, mund ta dërgojnë në Gjykatën Kushtetuese këtë ligj për ta kontestuar.

Një gjë të tillë e ka shfrytëzuar PDK-ja, duke iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Sipas Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, projektligji nuk procedohet nga ana e Kuvendit për shpallje të presidentja e Republikës së Kosovës.



Dekorohen ushtarët e FSK-së që ishin pjesë e operacionit të kërkim-shpëtimit në Turqi

Presidentja Vjosa Osmani dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) kanë nderuar pjesëtarët e kësaj force të angazhuar në misionin humanitar të kërkim-shpëtimit në Turqi pas tërmetit shkatërrues, në të cilin humbën jetën mbi 46 mijë persona. Ekipe të kërkim-shpëtimit të FSK-së gjatë operacionit të kërkim-shpëtimit treguan profesionalizëm, përkushtim dhe performancë të lartë që rezultoi me shpëtimin e katër jetëve të qytetarëve të Republikës së Turqisë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 SHKURT - Pas sukseseve të treguara gjatë operacionit të kërkim-shpëtimit në zonat e prekura nga tërmeti në Turqi, Kontingjenti i Forcës së Sigurisë së Kosovës është kthyer në Kosovë, duke përmbyllur me sukses edhe një mision fisnik në shpëtimin e jetëve nga tragjedia në Turqi.

Ekipe të kërkim-shpëtimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës gjatë operacionit të kërkim-shpëtimit treguan profesionalizëm,

përkushtim dhe performancë të lartë që rezultoi me shpëtimin e katër jetëve të qytetarëve të Republikës së Turqisë.

Për t'i përgëzuar për kontributin, angazhimin dhe suksesin e treguar gjatë këtij operacioni, në aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës kanë dalë kryeministri Albin Kurti, ministri i Mbrojtjes Armend Mehaj, së bashku me komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, komandanti i Gardës Kombëtare, gjeneralbrigade Naim Haziri, zëvendëskomandanti i



Komandës së Logjistikës, kolonel Avdi Raci, ambasadori i Turqisë në Kosovë, oficerë të FSK-së, dhe kontingjenti nga Turqia që shërbejnë në Kosovë si dhe familjarë të pjesëtarëve. Me këtë rast komandanti i Forcës

së Sigurisë së Kosovës, pjesëtarët që u kthyen nga Turqia i shpërbleu me mirënjohje me motivacion "Shpëtoj jetë". Me një fjalë rasti kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i përshëndeti dhe i falënderoi pjesëtarët për angazhimin vetëmohues gjatë këtyre dy javëve në Turqi dhe shtoi: "Është obligim ynë humanitar për t'i ndihmuar njerëzit në nevojë dhe është detyrë jona t'i mbështetim partnerët tanë kur ata kanë nevojë për ndihmën tonë. Ndihma jonë dhënë Turqisë në këtë kohë të vështirë veç se ka ngritur në një nivel edhe më të lartë marrëdhëniet tona me Republikën e Turqisë". Ndërsa komandanti i FSK-së, gjeneral Jashari, takoi nga afër pjesëtarët e FSK-së, me ç'rast i falënderoi dhe shtoi se ndihet krenar për angazhimin dhe kontributin e djemve dhe të vajzave të FSK-së, që dhanë gjithçka nga vetja e tyre për të shpëtuar jetë gjatë operacionit të shpëtimit në Turqi.

Pas vendimit të marrë nga institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës dhe në koordinim me autoritetet e Republikës së Turqisë, Kontingjenti i FSK-së u dislokua po atë ditë në zonat e prekura nga tërmeti, duke ofruar kapacitetet profesionale të njësisë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (kërkim shpëtim urban, K9, mjekësi emergjente) për ta ndihmuar Republikën e Turqisë që të përballojë sa më lehtë këtë tragjedi.

Edhe presidentja Vjosa Osmani ka nderuar Kontingjentin e Forcës së Sigurisë së Kosovës të angazhuar në misionin humanitar të kërkim-shpëtimit në Turqi me Medaljen Presidenciale Ushtarake, për trimërinë, guximin e sakrificën e pashoq për shpëtimin e jetëve të njerëzve të prekur nga tragjedia e tmerrshme e tërmeteve në Turqi. "Forca jonë e Sigurisë mbetet sinonim i paqes dhe sigurisë në vend dhe në botë!", ka thënë presidentja Osmani.



Pjetër Shala: Jam i pafajshëm, akuzat ndaj meje janë shpifje dhe trillime

Hagë, 21 shkurt - Ish-pjesëtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Pjetër Shala, para trupit gjykues në Hagë, për pikat me të cilat akuzohet, ka thënë se është i pafajshëm. Ai e ka quajtur trillim aktakuzën e lexuar nga Prokuroria. "Po, e kuptova. Këto janë shpifje dhe trillime. Jam i pafajshëm", ka thënë ai.

Shala, i njohur me nofken "Komandant Ujku", po gjykohe për krime lufte. Ai akuzohet për ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje në Kukës, në një fabrikë metali për të cilën aktakuzat pretendon se u përdor nga UÇK-ja si qendër paraburgimi.

Të martën në Dhomat e Specializuara në Hagë, në gjykimin e Pjetër Shalës,



deklaratën hyrëse e ka filluar Zyra e Prokurorit të Specializuar. Sipas Prokurorisë, Pjetër Shala akuzohet për katër akuzat për krime lufte si ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë, vrasje e

paligjshme të kryera në fabrikën e metalit në Kukës.

Në zbatim të ligjit, prokurori i çështjes ka theksuar se Shala akuzohet për tri forma të përgjegjësive penale si: anëtar i

ndërmarrjes së përbashkët, si kryes fizik dhe ngarkohet si ndihmues dhe inkurajues për krimet e paraqitura në aktakuzë. Në deklaratën hyrëse, prokurori Alex Whiting u shpreh se në të gjitha çështjet gjyqësore shumica e viktimave janë shqiptarë. "Në të gjitha çështjet gjyqësore shumica e viktimave janë shqiptarë të Kosovës, në të gjitha rastet janë shqiptarë të Kosovës", tha prokurori. Whiting ka theksuar se askush nuk është mbi ligjin. "Personat që kanë kryer krime duhet të nxirren para drejtësisë. Ata janë përgjegjës para ligjit pavarësisht kauzës që luftojnë", ka thënë prokurori. Në deklaratën hyrëse, Prokuroria ka konsideruar se nga dëshmitë

do të tregohet se Shala ishte pjesë e një grupi që ka kryer krime. Prokuroria më tej ka deklaruar se janë keqtrajtuar 18 viktima në qendrën e ndalimit të ish-fabrikës së metalit në Kukës. "Akuza pretendon se grupi kriminal ka ndaluar dhe keqtrajtuar 18 viktima në qendrën e ndalimit të ish-fabrikës së metalit në Kukës. Ky grup kriminal ka vrarë njërin prej këtyre viktimave. Viktimat janë shënjestruar për shkak të afërsisë që kishin me serbët, janë trajtuar si bashkëpunëtorë, si spiunë... janë ndaluar pa asnjë proces të ligjshëm dhe në kohën që janë mbajtur të ndaluar u janë nënshtruar abuzimit, torturës dhe në një rast vrasjes", ka thënë prokurori Whiting.

A do të jemi ndonjëherë në gjendje të parashikojmë tërmetet?

Nga Richard GREY

Tragjedia e shpalosur midis ndërtesave që u shpërfaqën në Turqinë Juglindore dhe Sirinë Veriore, nxjerr në pah se sa shumë tërmete të papritura e të forta mund të na godasin. Dheshkencëtarët po synojnë të gjejnë mënyrat për të dalluar shenjat e hershme paralajmëruese të atyre që janë fatkeqësitë natyrore më të paparashikueshme.

Ato godasin papritur dhe pa paralajmërim. Dy tërmetet shkatërruese që goditën Turqinë Juglindore dhe Sirinë Veriore kanë marrë mijëra jetë dhe kanë lënë shumë të tjerë të plagosur apo të pa strehë. Të ndodhura në orët e para të 6 shkurtit, shumica e viktimave ishin në gjumë kur tërmeti i parë me magnitudë 7.8 të shkallë Rihter u rrëzoi godinat sipër trupave të tyre.

Disa orë më vonë, ai u pasua nga një tërmet i dytë i madh me magnitudë 7.5. Cektësia relative e të dy lëkundjeve, nënkuptonte që intensiteti i lëkundjeve ishte shumë i madh.

Dhe ndërsa zona vazhdon të dridhet nga pasgoditjet, ekspertët në Shërbimin Gjeologjik të Shteteve të Bashkuara kanë paralajmëruar se ata që mbijetuan dhe punonjësit e shpëtimit që po dynden tani në rajon për të ndihmuar, përballen me rreziqe të konsiderueshme nga rrëshqitjet e dheut dhe lëngëzimi i nëntokës si rezultat i lëkundjeve.

Por ndërsa bota është angazhuar në dërgimin e ndihmave për komunitetet e prekura në të dyja anët e kufirit midis Turqisë dhe Sirisë, disa po pyesin veten pse nuk e parashikuan dot këtë ngjarje. Sistemi i thyerjeve gjeologjike në Anadollit Lindor ku ndodhën tërmetet, është pjesë e një "bashkimi tektonik të trefishtë" ku shtyhen me njëra-tjetrën tre pllaka: pllaka e Anadollit, Arabisë dhe Afrikës.

Që nga viti 1970, vetëm 3 tërmete me një magnitudë 6 apo më të madhe e kishin goditur rajonin, dhe shumë gjeologë besonin se ai ishte "i vonuar" në përjetimin e një tërmeti tjetër të madh. Po pse nuk mundëm që ta parashikonim me saktësi atë? Në fakt shkenca e parashikimit të tërmeteve është shumë e vështirë.

Ndërsa shpeshherë ka sinjale të vogla që mund të zbulohen në të dhënat sizmike pasi të ketë ndodhur një ngjarje, të dish se çfarë të kërkojsh, dhe ta përdorësh atë për të bërë parashikime paraprake është shumë më sfiduese."Kur ne



simulojmë tërmetet në laborator, shohim që ndodhin të gjitha këto shenja të vogla. Si fillim ka plasaritje dhe disa çarje"-thotë Kris Marone, profesor i gjeoshkencave në Universitetin La Sapienza të Romës në Itali dhe në Universitetin Shtetëror të Pensilvanisë në SHBA.

"Por atje në natyrë ka shumë pasiguri, sepse shumë shpesh nuk kemi para-goditje apo shenja se do të ketë një tërmet të madh"- shton ai. Gjeologët janë përpjekur të përdorin metoda moderne shkencore për të parashikuar tërmetet që të paktën që nga vitet 1960, por me pak sukses.

Arsyeja thotë Marone, ka të bëjë kryesisht me kompleksitetin e sistemeve të pllakave tektonike që përshkojnë globin. Po ashtu ku shumë zhurmë sizmike. Toka gjëmon vazhdimisht në brendësinë e saj, dhe e kombinuar me zhurmën antropogjene të trafikut, punëve në ndërtim e sipër dhe jetës së përditshme, e bën të vështirë të dallosh sinjalet e qarta.

Sipas Shërbimit Gjeologjik të Shteteve të Bashkuara, për të pasur një parashikim vërtetë të dobishëm të tërmetit nevojiten 3 gjëra: vendndodhja, koha kur do të ndodhë, dhe sa i fortë do të jetë tërmeti. Deri më tani askush nuk mund ta bëjë këtë me një lloj sigurie.

Në vend të kësaj, gjeologët prodhojnë ato që janë supozimet e tyre më të mira në "hartat e rrezikut", ku ata llogaritin probabilitetin e një tërmeti brenda një harku kohor prej disa vitesh. Ndërsa këto harta mund të ndihmojnë deri diku tek planifikimi që ka të bëjë me përmirësimin e standardeve të ndërtimit në

zonat më të rrezikuara, ato nuk ofrojnë nivelin e duhur të parashikimit për të dhënë paralajmërimet e hershme për publikun, që t'i japë atij mundësi të evakuhet apo të strehohet në vende më të sigurta.

"Në Turqi dhe Siri, kishte shumë faktorë që nënkuptonin se ndërtesat ishin në një gjendje të tillë që ishin gati të shembeshin. Në shumë vende të botës perëndimore ka pasur kode të përforcimit sizmik që u zbatuan në vitet 1970-1980. Por ndërtimi dhe rikonstruksioni i godinave kushton shumë"-shton ai.

Prandaj shkencëtarët kanë kërkuar mënyra për t'i bërë më të saktë parashikimet e tërmeteve. Krahas sinjaleve sizmike, studiuesit kanë kërkuar të dhëna në një larmi vendesh, nga sjellja e kafshëve deri tek valët elektrike në atmosferën e sipërme të Tokës. Ndërkohë kohët e fundit ka shumë shpresë tek aftësitë e Inteligjencës Artificiale për të zbuluar llojin e sinjaleve delikate që na shpëtojnë ne njerëzve. Algoritmet e makinerive, mund të analizojnë sasi të mëdha të dhënash nga tërmetet e kaluara për të kërkuar modele që mund të përdoren për të parashikuar ngjarjet e ardhshme.

Marone dhe kolegët e tij kanë zhvilluar gjatë 5 viteve të fundit algoritme, të cilat mendohet se janë të afta të zbulojnë dështimet në çarjet e simuluar në laborator. Duke përdorur blloqe graniti sa madhësia e një grushti, ata mund të rikrijnë stresin dhe fërkimin që mund të çojë në një çarje, duke e rritur presionin derisa kjo e fundit të rrëshqasë, duke krijuar atë që ata i quajnë "tërmete

laboratorike".

Gjithsesi Marone e pranon se ka ende pak përparim në këtë aspekt. Ndërkaq, shkencëtarët në Kinë kanë studiuar valëzimet tek grimcat e ngarkuara me elektricitet në jonosferën e Tokës në ditët para tërmeteve, të shkaktuara nga ndryshimet në fushën magnetike mbi zonat e thyerjeve tektonike.

Një grup i udhëhequr nga Jing Liu në Institutin e Parashikimit të Tërmeteve në Pekin, pretendoi se zbuloi 10 ditë para ndryshime në elektronet atmosferike mbi epiqendrën e tërmetit që goditi Kaliforninë në SHBA në fillim të prillit 2010. Një grup tjetër në Izrael, pretendoi kohët e fundit se ishte në gjendje të përdorte Inteligjencën Artificiale për të parashikuar tërmete të mëdha 48 orë para, me një saktësi 83 për qind duke ekzaminuar ndryshimet në përmbajtjen e elektroneve në jonosferë gjatë 20 viteve të fundit.

Në vitin 2018, Kina lëshoi në orbitë Satelitin Sismo-Elektromagnetik të Kinës (CES) për të monitoruar anomalitë elektrike në jonosferën e Tokës. Vitin e kaluar, shkencëtarët e Qendrës Rrjetit të Tërmeteve të Kinës me seli Pekin, pretenduan se kishin gjetur rënie në densitetin e elektroneve në jonosferë deri në 15 ditë përpara tërmeteve që goditën Kinën në maj 2021 dhe janar 2022.

"Një transferim energjie mund të ndodhë ndërmjet litosferës dhe dy shtresave sipër që është atmosfera dhe jonosfera"-thotë Mei Li, një nga studiuesit që punon në Qendrën e Rrjetit të Tërmeteve në Kinë. Por ajo thotë se mekanizmi se si ndodh kjo është ende i diskutueshëm.

Gjithsesi ajo paralajmëron se edhe me të dhënat satelitore, gjetjet e tyre janë ende shumë larg nga të qenit në gjendje të parashikojnë një tërmet të afërt. Po ashtu Li tregon edhe një problem tjetër: tërmetet e mëdha mund të shkaktojnë ndryshime në jonosferë shumë larg nga epiqendra e tyre, gjë që e bën të vështirë konfirmimin e vendndodhjes së saktë të tyre.

Raportet për kafshët që tremben dhe iknin në panik para tërmeteve datojnë që mijëra vjet më parë, por përdorimi i këtyre vëzhgimeve në një mënyrë kuptimplote është i vështirë. Sepse sjellja e kafshëve nuk lejon gjithmonë parashikimin e saktë.

Ka raporte për një tërmet të parashikuar në Kinë disa dekada më parë me ndihmën e sjelljes së pazakontë të kafshëve, por ajo nuk është përsëritur më. Studiues të tjerë po i mbështesin shpresat e tyre tek sinjale të ndryshme. Në Japoni, disa ekspertë pretendojnë se janë në gjendje të përdorin ndryshimet në avujt e ujit mbi zonat e tërmetit për të bërë parashikime. Testet sugjerojnë se këto parashikime kanë 70 për qind saktësi, megjithëse mund të thonë vetëm se një tërmet mund të ndodhë në një moment gjatë muajit të ardhshëm. Të tjerë janë përpjekur të përdorin valëzime të vogla në gravitetin e Tokës që mund të ndodhin përpara një tërmeti. Por pavarësisht nga të gjitha këto pretendime, asnjë nuk ka qenë në gjendje të parashikojë me sukses se ku dhe kur do të ndodhë një tërmet përpara se të ndodhë vërtet.

Marrë me shkurtime nga
"BBC" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Prishtina kërkon këndelljen ndaj Dritës

FC Prishtina pas dy humbjeve në Superligë është përgatitur për t'i marrë tri pikë në derbin ndaj Dritës. "Motivi i skuadrës tonë është për t'u kthyer të fitoret dhe në vendin dhe ku e meriton skuadra së bashku me tifozët", ka thënë Useini. Ndërsa në anën tjetër gjilanasit kërkojnë vazhdimësi të fitoreve në mënyrë të jenë në garë për titull deri në fund

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 SHKURT - Derbi i madh në futbollin e Kosovës zhvillohet sot (e mërkurë) mes Prishtinës dhe Dritës, në kuadër të javës së 21-të në Superligë. Kryeqytetasit kanë humbur dy ndeshjet e fundit dhe ndaj Dritës kërkojnë që t'i rikthehen fitoreve dhe të fillojnë një cikël me rezultate pozitive. Kjo ndeshje zhvillohet në stadiumin "Sami Kelmendi" me fillim nga ora 13:00. Para kësaj ndeshje përfaqësohet nga klubi i klubit ka folur Muhamed Useini. Ai ka thënë se forca e

një ekipi shihet kur reagon pas humbjes, derisa e konsideron si ndeshje të vështirë përballjen me skuadrën nga Gjilani. "Do të jetë ndeshje e vështirë kundër një kundërshtari të mirë, mirëpo sikurse në çdo ndeshje, edhe kësaj radhe do të futemi për më të mirën dhe shpresoj se tre pikë do të mbeten tek ne. Forca e një ekipi shihet atëherë kur reagon pas humbjeve, duhet reaguuar për t'u rikthyer. Prishtina shumë shpejt do të rikthehet te fitoret dhe lojtarët e mira. Motivi i skuadrës tonë është për t'u kthyer të fitoret dhe në vendin dhe ku e meriton skuadra së



bashku me tifozët", ka thënë Useini. Në anën tjetër, Drita ka shënuar fitore në ndeshjen ndaj Dukagjinit dhe kërkon që të vazhdojë serinë pozitive në Superligë dhe të jetë në hap me Ballkanin në garën për titull. Për ndeshjen ndaj Prishtinës foli edhe trajneri i Dritës, Arsim Thaqi, i cili thënë se skuadra e tij nuk guxon të bëjë asnjë hap fals nëse dëshiron të vazhdojë rrugën për titull. "Pas fitores gjërat gjatë javës

shkojnë shumë mirë qoftë për trajnerin qoftë për lojtarët janë më të motivuar dhe të angazhuar në stërvitje. Prishtina është ekip i madh me histori në futbollin e Kosovës dhe do të qasemi me seriozitetin maksimal. Ne kemi analizuar Prishtinën duke i lënë anash humbjet e kundërshtarit ne duhet të fokusohemi te loja jonë dhe të bëjmë më të mirën në ndeshje. Ata dinë të organizohen dhe në

momente të caktuara të bëjnë kthesa, prandaj çdo ndeshje është si finale dhe duhet fitohet. Lojtarët besoj e kanë kuptuar cili është qëllimi jonë. Çdo pikë e humbur për ne është e parikuperueshme", ka thënë Thaqi në konferencë për media. Krahas kësaj ndeshje sot zhvillohen edhe dy ndeshje tjetër. Malisheva e pret Llapin, kurse Drenica ka punë me Gjilani. Dy ndeshjet tjera të kësaj xhiro zhvillohen të enjten dhe takohen Trepça '89-Ballkani dhe Dukagjini-Llapi.

SUPERLIGA - Xhiro 21

Të mërkurë takohen:
13:00 Prishtina - Drita
13:00 Malisheva - Llapi
13:00 Drenica - Gjilani

Të enjten takohen:
13:00 Trepça '89 - Ballkani
13:00 Dukagjini - Llapi

Sonte përballen Inter - Porto dhe Leipzig - City

"Epoka e re"

MILANO, 21 SHKURT - Përballje interesante do të zhvillohen edhe sonte në Ligën e Kampioneve. Përballen Interi me Porton dhe Leipzigu me Manchester Cityn. Interi, që është nikoqir i Portos, e pret skuadrën portugeze me synim për ta marrë fitoren dhe për t'iu afruar kualifikimit tutje. Ekipi që drejtohet nga Simone Inzaghi ka përfunduar në vendin e dytë të Grupit C, pas Bayern Munchenit dhe para Barcelonës dhe Viktorias Pzenit. Në anën tjetër, Porto

ishte e para në Grupin B. Skuadra italiane në kampionatin vendor është në vendin e dytë, por ka mbetur 15 pikë prapa skuadrës së Napolit dhe synim ka të dalë sa më e suksesshme në garën më të fortë në futboll, Ligën e Kampioneve. Ndërsa skuadra e Portos renditet e dyta në Premierë Ligë me pesë pikë pas Benficës. Mungesa e vetme e Interit është sulmuesi Joaquin Correa, ndërsa te portugezët mungojnë Evanilson, Fabio Cardoso, Gabriel Veron dhe Francisco Meixedo. Ndërsa kampioni në fuqi i Premierë Ligës,

Manchester City, e nis fushatën me eliminim direkt në Ligën e Kampioneve me udhëtim në Gjermani, ku do të përballen me RB Leipzigin. City kërkon hakmarrje në "Red Bull Arena" pasi humbi ndeshjen e grupeve në sezonin e kaluar me rezultat 2-1, mirëpo edhe gjermanët kanë synime të mëdha dhe kjo pritet një sfidë mjaft interesante.

TË MËRKURËN TAKOHEN:
21:00 Inter - Porto
21:00 Leipzig - Manchester City



'Dardanet' shkëlqyen edhe ndaj Bullgarisë



PRISHTINË, 21 SHKURT - Në ndeshjen e tretë dhe, mbase, lojën më të mirë gjatë këtij turneu kundër Bullgarisë, vashat e Përfaqësueses A të Kosovës shënuan fitore me rezultat 2-1, duke e përmbyllur

në mënyrën më të mirë pjesëmarrjen në turneun miqësor "Turkish National Womens Cup Alanya 2023". Në ndeshjen e parë "dardanet" e mundën Estoninë me rezultat 2-1, pastaj Hong Kongun me

shifrat 7-0. Në ndeshjen ndaj bullgareve ishte një mbizotërim i plotë i Kosovës. Golat për Kosovën i shënuan Erëleta Memeti dhe Valentina Metaj, ndërsa për bullgaret shënuese ishte Naydenova.

Sot grumbullohet Përfaqësuesja U17 në hendboll

GJAKOVË, 21 SHKURT - Sot (e mërkurë) në Gjakovë grumbullohen hendbollistet e Përfaqësueses U17 të Kosovës. Kjo përfaqësuese merr pjesë në Kampionatin e 16-të Mesdhetar që mbahet në Greqi prej 26 shkurtit deri më 5 mars.

Kryetrajneri i Përfaqësueses U17, Mitat Ferati, më herët ka shpallur listën e lojtareve në të cilat llogaritet. Mesdhetari vlerësohet garë e fortë, ndërsa synimi i Kosovës është zhvillimi i mëtejshëm. Ky do të jetë grumbullimi i tretë i kësaj

gjenerate. Algjeria, Kroacia, Greqia, Italia, Mali i Zi, Rumania, Spanja, Tunizia dhe Turqia janë kombëtaret e tjera pjesëmarrëse. Pas disa ditësh përgatitje në Gjakovë, Përfaqësuesja e Kosovës udhëton për në Greqi.



Vojvoda kërkon fitore kundër Juventusit

TORINO, 21 SHKURT - Mbrojtësi i Torinos dhe Përfaqësueses së Kosovës, Mërgim Vojvoda, ka folur para sfidës derbi të qytetit industrial italian. Anëtori që paraqitet për skuadrën e kuqe ka thënë se dëshiron një fitore kundër

“Zonjës së Vjetër”. Këto deklarime i bëri pas barazimit me Cremonesen, teksa për mikrofonat e “Sky” ka thënë se tash e ka mësuar rëndësinë e ndeshjes. “Jam mirë, ndeshja ndaj Juventusit është shumë e rëndësishme. Aktualisht ndiej

pak dhimbje, por besoj se do të kalojë shpejt. Tani jam në sezonin e tretë me Torinon dhe e kam kuptuar shumë mirë rëndësinë e derbit, sidomos për tifozët tanë. Do të bëjmë gjithçka për të fituar dhe për ta ‘veshur’ qytetin me ngjyrat

tona”, ka thënë Vojvoda. Torino momentalisht është në mes të tabelës, saktësisht në pozitën e nëntë, ku pas 23 ndeshjesh numëron 31 pikë dhe deri në fund do të përpiqet të sigurojë një vend në garat evropiane.



Scaloni: Messin e pres edhe në 2026-n

BONUES AIRES, 21 SHKURT - Lionel Scaloni ishte i ftuar special në Qendrën Sportive, Coverciano, me teknikun argjentinas që bisedoi gjatë me kolegët e tij në futbollin italian. Një pjesë e mirë ishte edhe rreth suksesit të Argjentinës në Botërorin e Katarit, ku Lionel Messi me shokë ngritën në qiell trofeun e shumë ëndërruar për të gjithë popullin argjentinas. Tekniku 44-vjeçar u shpreh se pas triumfit “fshihej” një komunikim shumë i mirë mes stafit, lojtarëve dhe tifozëve. Ndër të tjera, Scaloni theksoi se Messi e ka “derën të hapur” edhe për Botërorin e vitit 2026. “Një nga aspektet më të rëndësishëm në rrugëtimin tonë në Botëror ishte komunikimi, komunikimi mes lojtarëve dhe stafit, por edhe me tifozët. Kishim një lidhje të ngushtë me ta, ishte emocionale dhe kjo na bënte që ta donim fanellën edhe më shumë. Pastaj, sigurisht të kesh



në skuadër një lojtar si Messi është avantazh i madh. Si një ish-shok skuadre i tij, ta trajnosh është po aq bukur, shoh se si lojtarët e tjerë e ndjekin dhe e kërkojnë në fushë. Ai është lider”, ka thënë

Scaloni. “Messi në 2026-n? Nëse do të luajë në Botërorin e ardhshëm apo jo, është një vendim që i takon Messit. Nëse do të jetë mirë fizikisht dhe trupi do t’i përgjigjet, unë e pres”, u shpreh Scaloni.

LeBron: Këto janë 23 ndeshjet më të rëndësishme të karrierës time

LOS ANXHELOS, 21 SHKURT - Me 27 fitore dhe 32 humbje, skuadra e Lakersave është jashtë zonës “play-off” në NBA këtë sezon. Ky do të thotë një tjetër sezon i dështuar për kalifornianët, që për të dytin vit me radhë rrezikojnë të mos shkojnë në “play-off” (ku shkojnë gjashtë ekipet e para) apo në “play-in” (luajnë ekipet në vendet 7-10). Lakersat aktualisht renditen në vendin e 13-të, por renditja është e ngjeshur dhe asgjë nuk është e pamundur. Pas ndeshjes së “All Star Game”, kapiteni i Lakersave, LeBron James, ka folur për pjesën e mbetur të sezonit. Ai beson se edhe merkatoja e janarit e kryer nga klubi do të japë rezultat. “Janë ende edhe 23 ndeshje për t’u luajtur. Do të jenë 23 ndeshjet më të rëndësishme të karrierës time për një sezon të rregullt. Ky është mentaliteti im. Shpresoj që kjo gjë të vlejë edhe për shokët e mi të skuadrës, për ta arritur objektivin minimal, që është ‘play-off’-i”, ka thënë LeBron Jamesi. Dy javë më parë “king



James” u bë shënuesi më i mirë në historinë e NBA-së, duke kaluar legjendën Kareem Abdul-Jabbar. Kampionati do të rinisë pas disa

ditësh pushime për shkak të ndeshjes së yjeve, zhvilluar në Salt Lake City, ku “team Giannis” mposhti atë të “team LeBron”.

SHKURT

Chelsea mendon ta rikthejë Mourinhon

Milionat e shpenzuara në dy afatet kalimtare të një sezoni nuk e kanë ngritur Chelsean në pozicionin ku pritej. Trajneri aktual Potter nuk e ka të sigurt qëndrimin në stolin e bluve, pasi në pesë ndeshjet e fundit në ligën angleze ka arritur të marrë vetëm një fitore, tri barazime dhe një humbje, ku më e frikshmeja është se ka arritur të shënojë vetëm një gol. Kështu, sipas “Gazzetta.it”, nëse Jose Mourinho do të largohej nga Roma në fund të sezonit, Chelsea do ta konsideronte të parin në listë portugezin për t’u rikthyer në stolin e ekipit.

Ten Hagen kërkon të ‘blindohet’ Rashfordi

Marcus Rashford është shndërruar në protagonist absolut të Manchester Unitedi këtë sezon: 24 gola dhe 8 asistime në 36 ndeshje. Erik ten Hag u ka kërkuar drejtuesve të klubit ta “blindojnë” sulmuesin anglez. Sipas “Sky Sport UK”, tekniku holandez kërkon që rinovimi i kontratës me Rashfordin të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur, për të shmangur çdo skenar të padëshiruar në fund të këtij sezoni. Rashfordi ka një kontratë me Manchester Unitedin deri më 2024.

Neymari rrezikon ndeshjen kthyesë ndaj Bayernit

Neymari është lënduar në ndeshjen e fundit në Ligën 1 ku Paris Saint-Germain e mposhti Lillen (4-3). Ylli brazilian pas këtij lëndimi është në dyshim për ndeshjen kthyesë në Ligën e Kampioneve ndaj Bayern Munchenit. Pritet që Neymari të jetë jashtë fushës për 3-4 javë.

Gullit: Milani po vuan më shumë se vjet, të shohim si do të jetë në LK

Gjatë një interviste për “Gazzetta dello Sport”, ish-ylli i Milanit, Ruud Gullit, foli për sezonin e zhvilluar deri tani nga skuadra e Stefano Piolit. “Kuqezinjtë po luftojnë dhe vuajnë. Deri tani gjithçka nuk ka qenë aq e lehtë sa sezonin e kaluar. Ndoshta sepse më 2021-2022 gjithçka shkoi në drejtimin e duhur, ndërsa tani... Në këtë pjesë të parë të sezonit, gjërat kanë qenë më të vështira nga sa prisnin të gjithë, por në futboll nuk dihet kurrë. Në Ligën e Kampioneve fitoi ndeshjen e parë të 1/8 finale kundër Tottenhamit. Le të shohim se si do të përfundojë kthimi në Londër”, u shpreh legjenda holandeze.

PSG-ja planifikon rikthimin e Tuchelit

Paris Saint-Germaini është i vendosur ta rikthejë trajnerin Thomas Tuchel. Gjiganti francez ka ndër mend t’ia japë trajnerit gjerman ekipin në dorë për herë të dytë, njofton mediumi britanik “Evening Standard”. Kampioni francez po planifikon t’i ndajë rrugët me trajnerin Christophe Galtier, mbi të gjitha, pas humbjes në shtëpi nga Bayern Muncheni në të tetën e finales së Ligës së Kampioneve, por edhe pas disa humbjeve në kampionat. Prandaj, gjithnjë e më shumë po shtohen zërat për një rikthim të ish-trajnerit të Chelseat në “Parkun e Princave”.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "ISP-TIK" SH.P.K. me seli në Malishevë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b. 811151068 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "ISP-TIK" D.O.O. Malishev, donelo odluku o prestani rada sa nr.b. 811151068 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "ISP-TIK" L.L.C. Malishevë, has come to the decision to quit its business: 811151068 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Albitaly Web" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. Unik Identifikues 810099508.

- Dijar Hoti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh Ekonomike "Kadri Kusari".

- Adelina Salihu nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10.11 të SH.M. Ekonomike " Kadri Kusari" Gjakovë.

- Drin Jakurti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Shkelqim Rexha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shfmu "Yll Morina" Gjakovë nga kl.I-IX.

- Qëndrim Haziri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Shkelqim Rexha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shfmu "Mustafa Bakija" nga kl. I-V Gjakovë.

- Shqipe Mazreku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën diplomën e shm Mjekësisë "Hysni Zajmi".

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

